



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG**

---

Numri i lëndës: 2023:229276

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05504453

**PPP.nr.27/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA ISTOG**, Departamenti i Pergjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Pajtesë Boshnjaku në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a.(KESco) me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Klinton, numër 5, ndaj debitorit H.B nga fshati T., Komuna I., nga baza juridike përmbarimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat Fatos Shatri në Pejë P.nr.130/2019 i datës 11.03.2019, jashtë seancës gjyqësore, me datë 26.03.2024 merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.PRANOHET Pjesërisht i BAZUAR** prapësimi i debitorit H.B, nga fshati T., Komuna I., i parashtruar kundër urdhrit të Përmbaruesit Privat Fatos Shatri në Pejë P.nr.130/2019 i datës 11.03.2019, për shumën e borxhit të kërkuar prej 1,193.31 €.

**II.REFUZOHET I PABAZUAR** prapësimi i debitorit për pjesën tjetër të detyrimit në të holla në shumën prej 26.32 €, të cilin detyrim në të holla obligohet pala debitore që ta përmbush ndaj kreditorit.

**A r s y e t i m**

Kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a.(Kesco) me seli në Prishtinë, me datë 11.03.2019, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me energji elektrike për periudhën kohore nga data 05.10.2013 deri me datën 06.02.2019, baza juridike borxh në vlerë prej 1,803.45€.

Përmbaruesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit me Urdhrin P.nr. 130/19 të datës 11.03.2019, ka lejuar përmbarimin e propozuar.

Debitori në afatin e lejuar ligjor, me datë 18.10.2023 ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhëri përmbarimor, duke u thirr në parashkrimin e borxhit, skadimin e afatit kohor brenda të cilit mund të kërkohet përmbarimi, se dokumenti përmbarues nuk është i përshtatshëm për përmbarim, faturimit të parregullt nga ana e kreditorit dhe vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike.

Përfaqësuesi i kreditorit në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilin ka propozuar që urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi, duke shtuar se pretendimi i debitorit se borxhi është parashkruar, nuk qëndron pasi që kreditori ka bërë precizimin e kërkesës për periudhën kohore prej datës 05.10.2013 deri me datën 06.02.2019 në shumën prej 1,803.45 euro. Më tej ka shtuar se tek transaksionet e debitorit shihen pagesa të kryera me çrast me pagesa vullnetare të debitorit është e mjaftueshme për të manifestuar pranimin e borxhit ex lege, ky fakt shkakton ndërprerjen e parashkrimit dhe atë konform nenit 368 të LMD-së.

Gjykata në procedurën përmbarimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e pales debitore, përgjigjen në prapësim të dhënë nga pala kreditore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka gjetur se prapësimi është pjesërisht i bazuar.

Në propozimin për përmbarim të datës 11.03.2019, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Fatos Shatri me Urdhrin P.nr.130/19, në bazë të dokumentit të besueshëm, ekstrakti nga librat afariste, nga kreditori është kërkuar borxhi për periudhën nga data 05.10.2013 deri me datën 06.02.2019.

Gjykata pas vlerësimit të ekstraktit gjen se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, duke u bazuar në nenin 360 të LMD, paragrafët 1, nën paragrafi 1.1., 2 dhe 3 ku përcaktohet se: *1. Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake; 2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë; 3. Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë.* Gjykata gjen se, në bazë të ekstraktit nga librat afarist, debitori nga data 05.10.2013 e deri më 24.12.2013 ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 113.07 €, kurse ka bërë pagesa në vlerë 50.00 €, e që borxhi i mbetur për vitin 2013 është në vlerë prej 63.07 €. Në vitin 2014 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 633.98 €, kurse ka bërë pagesë të energjisë elektrike, prej 20 € e që borxhi i mbetur për vitin 2014 është 613.98 €. Në vitin 2015 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 650.85 €, dhe ka bërë pagesë në vlerë prej 160.00 € e që borxhi i mbetur për vitin 2015 është 490.85 €. Në vitin 2016 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 462,03 dhe ka bërë pagesë në vlerë prej 568.14, rrjedhimisht për këtë periudhë nuk ka fare borxh debitori. Në vitin 2017 debitori ka

shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 25.41 € dhe nuk ka bërë fare pagesë të energjisë elektrike, e që borxhi i mbetur për vitin 2017 është në vlerë prej 25.41 €. Në vitin 2018 debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 20.68 € dhe nuk ka bërë fare pagesë të energjisë elektrike, e që borxhi i mbetur për vitin 2018 është në vlerë prej 20.68 €. Ndërsa për vitin 2019 borxhi i mbetur është në vlerë prej 5.64 €, ngase debitori ka shpenzuar energji në këtë vlerë dhe nuk ka bërë pagesë.

Sipas vlerësimit të gjykatës borxhi i vitit 2013, vitit 2014, vitit 2015, vitit 2016 dhe vitit 2017 në vlerë të përgjithshme prej 1,193.31 € është i parashkruar, pasi që afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. Së këndejmi, borxhi i vitit 2013 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2013, ndërsa është parashkruar pas një viti, përkatësisht me 31 dhjetor të vitit 2014, borxhi i vitit 2014 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2014, ndërsa është parashkruar pas një viti, përkatësisht me 31 dhjetor të vitit 2015, borxhi i vitit 2015 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2015, ndërsa është parashkruar pas një viti, përkatësisht me 31 dhjetor të vitit 2016, borxhi i vitit 2016 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2016, ndërsa është parashkruar pas një viti, përkatësisht me 31 dhjetor të vitit 2017, borxhi i vitit 2017 ka arritur për pagesë në fund të vitit 2017, ndërsa është parashkruar pas një viti, përkatësisht me 31 dhjetor të vitit 2018, kurse përmbartimi është lejuar me datën 11.03.2019. Rrjedhimisht, gjykata duke u bazuar në këto gjetje, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Më tej, debitori gjatë vitit 2018, në bazë të ekstraktit nga librat afarist, ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 20.68 €, dhe nuk ka bërë fare pagesë e që borxhi i mbetur për vitin 2018 është në vlerë prej 20.68 €, kurse në vitin 2019 deri më datë 19.02.2019, debitori ka shpenzuar energji elektrike në vlerë prej 5.64 €, € dhe nuk ka bërë fare pagesë e që borxhi i mbetur për vitin 2019 është 5.64 €, €.

Borxhi i vitit 2018 dhe 2019 deri me datë 19.02.2019 në total është 26.32 €, të cilën debitori është i detyruar ta paguaj sepse për këtë borxh nuk ka arritur parashkrimi, pasi që afati i parashkrimit për borxhin e vitit 2018, fillon të rrjedh nga fundi i vitit, dhe se afati 1 vjeçar i parashkrimit do të arrinte me 31 dhjetor 2019.

Si përfundim, debitori ka borxh ndaj kreditorit shumë në vlerë prej 26.32 €, i cili nuk është parashkruar, andaj edhe e refuzoj pjesërisht prapësimin e debitorit në shumën prej 26.32 €, duke vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Ndërsa, pretendimin e kreditorit se pagesat e bëra nga debitori kanë ndërprerë parashkrimin, konform nenit 368 të LMD në paragrafët 1 dhe 2, ku përcaktohet: *1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin; 2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e*

*sigurimit, gjykata i vlerësoi si të pabazuara, sepse sipas vlerësimit të gjykatës parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë dhe se pagesat e bëra nga debitori nuk e ndërprejnë parashkrimin, pasi që nuk kemi të bëjmë me pagesë të kështit, ngase pagesa e kështit mund të bëhet vetëm nëse ka marrëveshje mes kreditorit dhe debitorit për pagesën e borxhit në këste të caktuara, ndërsa pagesat e rregullta bëhen nga ana e debitorit varësisht nga shërbimet e marra nga kreditori. Së këndejmi, këto pagesa nuk nënkuptojnë se debitori ka vullnet për pranimin e borxhit në tërësi. Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: *gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përyjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit.**

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e tjera nga palet por ishin pa ndikim në marrjen e këtij vendimi, andaj nga arsyet e theksuara me lartë, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA ISTOG**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL**  
**PPP.nr.27/2023, me datë 26.03.2024**

**Gj y q t a r j a**  
Pajtesë Boshnjaku

**UDHËZIM JURIDIK:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.